



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 46/2023 (JR)
Nr. 46/ 3 regj.

Tiranë më 11.06.2024

SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet e procesit, si dhe të gjithë personat e interesuar, se **ditën e mërkurë, datë 10.07.2024, ora 10:00**, do të shqyrtohet në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, çështja me nr. regjistri (JR) 46/2023, datë 18.10.2023, që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Sami Ujkashi kundër vendimit nr. 692, datë 28.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.

Trupi gjykues, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese e trupit gjykues
Relatore e çështjes
Anëtare
Anëtare
Anëtare

Albana Shtylla
Mimoza Tasi
Ina Rama
Natasha Mulaj
Rezarta Schuetz

Bazuar në nenin 49, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të paraqesë deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.

Bazuar në nenin 482, pika 3, të Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit të çështjes, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES
GJYQTARE

ALBANA SHTYLLA